

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Sanisil®

IZOLUES SILIKONI PËR APLIKIME NË PAJISJET HIDROSANITARE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Sanisil® është izolues silikoni me 1 përbërës, që nuk varet dhe ka rezistencë afatgjatë ndaj kërpudhave dhe mykut.

PËRDORIMET

- Aplikime në pajisjet hidrosanitare apo izolime të tjera ku kërkohet rezistencë ndaj mykut dhe kërpudhave
- Kuzhina shtëpie
- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë afatgjatë e mirë ndaj kërpudhave dhe mykut
- Ngjitje shumë e mirë mbi shumicën e nënshtresave joporoze
- Rezistencë e mirë ndaj rrezatimit UV dhe vjetërimit nga kushtet e motit
- Pa tretës (sipas TRGS 610)
- Elasticitet dhe fleksibilitet i lartë

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-3 - Izolues për përdorim jostrukturor në fugat e ndërtesave - izolues për hidrosanitare

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Silikon acetoksid	
Ambalazhi	Tubetë 300 ml: 12 copë/ kuti	
Ngjyra	I bardhë, transparent	
Jetëgjatësia	18 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +25 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.	
Dendësia	~1,00 kg/l	(ISO 1183-1)
Deklarata e produktit	EN 1565-3: S XS1	

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~20 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~1,8 N/mm ²	(ISO 8339)
Moduli i shformimit elastik	~0,35 N/mm ² në 100% zgjatim (+23 °C)	(ISO 8339)

Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Sanisil®

Dhjetor 2019, Botimi 03.01

02051403000000011

Zgjatimi deri në thyerje	~550 %	(ISO 37)
Risjellja elastike	> 90 %	(ISO 7389)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~2,6 N/mm	(ISO 34)
Aftësia për lëvizje	±20 %	(ISO 9047)
Temperatura e funksionimit	-40 °C / +100 °C	
Projektimi i fugës	Përmasat e fugës duhet të projektohen që të përshtaten me aftësinë për lëvizje të izoluesit. Për gjerësi fugash më të mëdha se 10 mm dhe më pak se 20 mm, rekomandohet një thellësi fuge prej 10 mm. Për fuga më të gjera, kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione shtesë.	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Gjerësi fuge [mm]	Thellësi fuge [mm]	Gjatësi fuge [m] për 300 ml
	10	10	3,0
	15	10	2,0
	20	10	1,5

Konsumimi varet nga ashpërsia dhe absorbueshmëria e nënshtresës. Këto vlera janë teorike dhe nuk përlllogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit apo profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Material mbështetjeje	Për mbështetjeje, përdorni kordon prej shkume polietileni.		
Rrjedha e varjes	< 1 mm (profil 20 mm, +23 °C)	(ISO 7390)	
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.		
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max., min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës		
Ritmi i maturimit	~3,0 mm/24 orë (+23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP* 049-2)	
		*Sika Corporate Quality Procedure	
Koha e krijimit të kores	~25 min (+23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 019-1)	

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislleqe, vaj, graso, izolues të vjetër dhe veshje boje me ngjitje të dobët të cilat mund të ndikojnë në ngjitjen e izoluesit. Nënshtresa duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme për t' u rezistuar sforcimeve që i nënshtrohen nga izoluesi gjatë lëvizjes. Mund të përdoren teknika largimi si pastrimi me furçë teli, bluarje ose mjete mekanike të përshtatshme. Pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të pastrohet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet duke përdorur një pajisje të përshtatshme, përpara aplikimit të aktivizuesit, prajmerit ose izoluesit. Sika® Sanisil® ngjitet pa prajmera dhe/ose aktivizues. Për ngjitje optimale, qëndrueshmëri fuge dhe aplikime kritike me performancë të lartë si fugat e ndërtesave shumëkatëshe, fugat me sforcim të lartë, ekspozim në

kushte ekstreme moti ose ekspozim / zhytje në ujë. Duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lysterjes me prajmer dhe/ose trajtimit paraprak:

Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metale të veshura me pluhur apo pllakat me glazurë duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht duke përdorur Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër.

Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 15 minutash (< 6 orë).

Metale të tjera si bakri, bronzi dhe titanium-zinku, duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Pas kohës së nevojshme të tharjes, përdorni një furçë për të aplikuar Sika® Primer-3 N dhe lini kohë shtesë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë)

PVC duhet të pastrohet dhe të trajtohet paraprakisht me Sika® Primer-215 të aplikuar me një furçë. Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë). Qelqi duhet të pastrohet me Isopropanol përpara aplikimit.

Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Sanisil®

Dhjetor 2019, Botimi 03.01

02051403000000011

BUILDING TRUST



Nënshtresa poroze

Nënshtresat poroze duhet të lyhen me Sika® Primer-3 N të aplikuar me furçë. Për më shumë detaje si aplikimi dhe kohët e tharjes, lexoni skedën teknike më të fundit të produktit përkatës për trajtimin paraprak. Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

Duhet të kryhen testime të ndërkapjes mbi nënshtresat specifike të projektit dhe të gjitha palët të bien dakord me procedurat përpara aplikimit të plotë të projektit.

Për detaje më të detajuara dhe udhëzime, kontaktoni me shërbimin teknik Sika.

Shënim: Prajmerat dhe aktivizuesit përforcojnë ndërkapjen dhe nuk janë një alternativë për të përmirësuar përgatitjen / pastrimin e dobët të sipërfaqes së fugës. Prajmerat përmirësojnë gjithashtu performancën e ndërkapjes afatgjatë të fugës së izoluar.

PËRZIERJA

1 përbërës gati për përdorim

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ndiqui me rreptësi procedurat e instalimit siç përcaktohen në Method Statement, manualët e aplikimit dhe udhëzimeve të punimeve, të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier.

Maskimi

Rekomandohet përdorimi i shiritit për maskim aty ku kërkohen vija të drejta dhe të sakta fugash. Pasi të keni mbaruar, hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores.

Mbushja e fugës

Pas përgatitjes së kërkuar të nënshtresës, vendosni kordonin e përshtatshëm për mbushje në thellësinë e kërkuar.

Lyerja me prajmer

Nëse kërkohet, lyeni me prajmer sipërfaqet e fugave siç rekomandohet për përgatitjen e nënshtresës. Shmangni aplikimin e tepruar të prajmerit për të mos krijuar pëllgje në bazën e fugës.

Aplikimi

Sika® Sanisil® është gati për përdorim. Përgatisni tubetën, vendoseni tek pistoletat dhe mbërtheni majën. Nxirrni Sika® Sanisil® brenda fugës për të siguruar se vjen në kontakt të plotë me anët e fugës dhe se është shmangur bllokimi i ajrit.

Finirimi

Sapo të jetë e mundur pas aplikimit, izoluesi duhet të ngjeshet mirë në anët e fugës për të siguruar një ngjitje të mjaftueshme dhe finiturë të niveluar. Përdorni një agjent kompatibël për të niveluar sipërfaqen e fugës. Mund të përdoret ujë. Mos përdorni produkte përpunimi mekanik me përmbajtje tretësi.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht. Për pastrimin e lëkurës, përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

DOKUMENTA SHITESË

- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Sika® Sanisil® C nuk mund të lyhet.
- Mund të ndodhin ndryshime në ngjyrë për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (veçanërisht me ngjyrën e bardhë). Ky efekt është estetike dhe nuk ndikon negativisht në performancën teknike apo qëndrueshmërinë e produktit.
- Të mos përdoret për izolimin e fugave brenda dhe përreth pishinave.
- Të mos përdoret mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM apo mbi çdo material ndërtimi nga i cili mund të rrjedhë vaj, plastifikator apo tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.
- Të mos përdoret në hapësira plotësisht të mbyllura, pasi kërkon lagështi atmosferike që të thahet.
- Sika® Sanisil® nuk rekomandohet për sipërfaqe poroze si betoni, guri, mermeri dhe graniti. Mund të ndodhë njollosje nga migrimi i plastifikuesit, kur përdoret mbi këto nënshtresa. Duhet të kryhen testime paraprake përpara aplikimit të plotë të projektit për të kontrolluar nëse nënshtresa njolloset.
- Të mos përdoret aty ku pritet të ndodhë ekspozim fizik apo abrazion, ngjitje strukturore xhamash dhe izolim xhamash, apo aplikime në kontakt me ushqimet. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për produkte alternative.
- Të mos përdoret për përdorime mjekësore apo farmaceutike.
- Acidi acetik i çliruar gjatë tharjes mund të shkaktojë korrodimin e argjendit të pasqyrave dhe metaleve të ndjeshme si bakri, bronzi dhe plumbi.
- Të mos përdoret mbi sipërfaqe alkaline si betoni, suvaja dhe tullat.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Sanisil®
Dhjetor 2019, Botimi 03.01
02051403000000011

SikaSanisil-sq-AL-(12-2019)-3-1.pdf